



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Jedinica za upravljanje ljudskim resursima Human Resources Management Unit

Datë: 29/11/2024

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në pajtim me nenin 7 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, publikon:

NJOFTIM
Për Anulimin e Konkursit

Anulimi i konkursit për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare për Standardizim me nr. RN00015278 bëhet për arsye të tërheqjes së njërit kandidat nga konkurrimi.

Sipas legjislacionit aktual në fuqi, pranimi në pozitë të lartë drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publike, konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza:

- Verifikimi paraprak. përmes së cilit verifikohet nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit; dhe
- Vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve.

Po ashtu sipas legjislacionit në fuqi në rast se procedura e rekrutimit përfundon pa të paktën dy (2) kandidat/at fitues të vlerësuar mbi pragu minimal të shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit., organizohet procedurë e re rekrutimi.

Ne mungesë të konkurrencës prej dy kandidatëve procedura e rekrutimit ndërpritet dhe rrjedhimisht nuk janë krijuar kushte ligjore për të vazhduar rekrutimi në fazë tjetër.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

